

PHILIPS

Orë radio

DR402



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	Të rëndësishme	2
	Siguria	2
2	Ora radio	3
	Hyrje	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Përmbledhje e orës radio	4
3	Fillimi	5
	Instalimi i baterisë	5
	Lidhja me energjinë	5
	Vendosja e orës	6
	Ndezja	6
4	Dëgjimi i radios FM	7
	Përgatitja e antenës FM	7
	Kalimi te stacionet radio FM	7
	Ruajtja automatikisht e stacioneve të radios FM	7
	Ruajtja manualisht e stacioneve të radios FM	8
	Zgjidhni një stacion radioje FM të caktuar paraprakisht	8
	Rregullimi i volumit	8
5	Vendosja e alarmit	9
	Vendosja e alarmit	9
	Aktivizimi/çaktivizimi i alarmit	9
	Shtyrja/ndalimi i alarmit	9
6	Veçori të tjera	10
	Vendosja e shtyrjes së alarmit	10
	Rregullimi i ndriçimit të ekranit	10
	Drita e natës	10
	Karikimi i pajisjes me anë të portës USB	11
7	Informacione për produktin	12
	Specifikimet	12
8	Zgjidhja e problemeve	13
9	Njoftim	14
	Kujdesi për mjedisin	14

I Të rëndësishme

Siguria



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e kësaj ore radio.
 - Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të kësaj ore radio.
 - Asnjëherë mos e vendosni këtë orë radio mbi pajisje të tjera elektrike.
 - Mbajeni këtë orë radio larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.
 - Sigurohuni që ta arrini gjithnjë me lehtësi kordonin e energjisë, spinën ose adaptorin për ta shkëputur orën radio nga energjia.
-
- Lexoni dhe ndiqni këto udhëzime.
 - Sigurohuni që të ketë hapësirë të lirë të mjaftueshme anembanë orës radio për ajrim.
 - Përdorni vetëm shtesa/aksesorë të specifikuar nga prodhuesi.
 - Përdorni vetëm burimet e energjisë që janë përmendur në këtë manual.
 - Shkëputeni këtë orë radio nga priza gjatë stuhive me vetëtimë ose kur nuk përdoret për kohë të gjatë.
 - KUJDES lidhur me përdorimin e baterisë - Për të mos lejuar rrjedhjet e baterive të cilat mund të shkaktojnë lëndime, dëmtime të pronës, ose dëmtime të orës radio:
 - Montojini të gjitha bateritë si duhet, + dhe - siç janë shënuar në orën radio.
 - Hiqini bateritë kur ora radio nuk përdoret për kohë të gjatë.
 - Bateria nuk duhet të ekspozohet ndaj dritës direkte të diellit, zjarrit ose burimeve të ngjashme të nxehtësisë.
 - Ora radio nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.

- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi orë radio (p.sh. objekte të mbushura me lëng, qirinj të ndezur).
- Aty ku spina e energjisë të adaptorit direkt Plug-in përdoret si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.

Rrezik i gëlltimitjes së baterive!

- Pajisja mund të ketë një bateri të tipit monedhë/kopsë e cila mund të gëlltitet padashur. Mbajeni gjithnjë larg nga fëmijët! Nëse gëlltitet, bateria mund të shkaktojë lëndime serioze ose vdekje. Mund të ndodhin djegie të rënda brenda dy orësh pas gëlltimitjes.
- Nëse dyshoni se një bateri është gëlltitur ose është futur në ndonjë pjesë të trupit, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Kur ndërroni bateritë, mbajini gjithnjë bateritë e reja dhe ato të përdorura larg fëmijëve. Sigurohuni që vendi i baterisë të jetë krejt i sigurt pasi ta ndërroni baterinë.
- Nëse vendi i baterisë nuk mund të sigurohet komplet, mos e përdorni më produktin. Mbajeni larg fëmijëve dhe kontaktoni prodhuesin.



Shënim

- Etiketa e të dhënave ndodhet mbrapa aparatit.

2 Ora radio

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips!
Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep
Philips, regjistroni produktin në
www.philips.com/welcome.


Hyrje

Me këtë orë radio, ju mund të:

- dëgjoni radio FM;
- karikoni pajisjet portative; dhe
- vendosni dy alarme që të bien në orare të ndryshme.


Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:



- Ora radio
- Materialet e shtypura

Përmbledhje e orës radio



- ① **Source/**
 - Ndizeni ose fikeni radion
 - Vendosni alarmin (mbajeni shtypur)
- ② **TUNE/**
 - Aktivizoni kërkimin radio (modaliteti FM)
 - Vendosni shtyrjen e alarmit
- ③ **PRESET/**
 - Skanoni dhe ruani stacionet radio (modaliteti FM)
 - Rregulloni ndriçimin e ekranit
- ④ **VOLUME/**
 - Rregulloni volumnin (modaliteti FM)
 - Shkoni në stacione radioje FM (modaliteti FM)
 - Vendosni orën dhe minutat
 - Vendosni formatin 12/24 orë
- ⑤ **Ora/ekrani**
 - Aktivizoni butonat me prekje
 - Tregoni gjendjen aktuale
- ⑥ **Snooze**
 - Shtyjeni alarmin
- ⑦ **Vendi i baterisë**
- ⑧ **Porta e karikimit USB**
 - Karikoni telefonat tuaj
- ⑨ **Xheku i adaptorit të energjisë**

3 Fillimi

Ndiqui gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.

Instalimi i baterisë

! Kujdes

- Rrezik shpërthimi! Mbajeni baterinë larg nga nxehtësia, drita e diellit ose zjarri. Asnjëherë mos e hidhni baterinë në zjarr.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Bateria përmban substanca kimike, prandaj duhet të hidhet në mënyrën e duhur.

≡ Shënim



- Mund të përdorni vetëm energji AC si burim energjie. Bateria CR2032 prej litiumi mund të ruajë vetëm vendosjen e orës dhe alarmit.
- Kur shkëputet energjia, ekrani fiket.

Për përdorimin në herë të parë:

Hiqni veshjen mbrojtëse për ta aktivizuar baterinë.

Për ta ndërruar baterinë:

- 1 Shtyjeni kapësen në të majtë dhe tërhiqeni jashtë sirtarin e baterisë.




- 2 Vendosni një bateri CR2032 siç tregohet në figurë.

Lidhja me energjinë


! Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është printuar mbrapa ose poshtë orës radio.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur shkëputni spinën AC, tërhiqni gjithnjë spinën nga priza. Asnjëherë mos tërhiqni kordonin.

Lidhni adaptorin e energjisë me prizën në mur.



Vendosja e orës



- 1 Mbani shtypur sipërfaqen e orës për 3 sekonda për të aktivizuar vendosjen e orës.
↳ [12H] fillon të pulsojë.
- 2 Shtypni për të vendosur formatin 12/24 orë.
- 3 Shtypni për të konfirmuar.
- 4 Shtypni vazhdimisht për të vendosur orën.
- 5 Shtypni për të konfirmuar.
- 6 Shtypni vazhdimisht për të vendosur minutat.
- 7 Shtypni për të konfirmuar.
↳ Shfaqet ora e vendosur.

Ndezja


Shtypni për ta ndezur radion.

- ↳ Produkti kalon në modalitetin e kërkimit FM.

4 Dëgjimi i radios FM

Përgatitja e antenës FM


Për marrje më të mirë të sinjalit, zgjatni plotësisht dhe rregulloni pozicionin e antenës në formë bishti.



Shënim

- Për të parandaluar interferencat, pozicionojeni antenën sa më lart të jetë e mundur nga pajisjet e tjera elektrike.

Kalimi te stacionet radio FM



- 1 Prekni sipërfaqen e orës për të aktivizuar butonat me prekje.
- 2 Shtypni për të ndezur radion FM.

- 3 Shtypni dhe mbani shtypur **TUNE** për tre sekonda.



- 4 Shtypni dhe mbani shtypur / për tre sekonda.

↳ Ora radio kalon automatikisht në një stacion radio me sinjal të fortë.

- 5 Përsëritni hapin 4 për të shkuar në stacione të tjera radioje.


Për të shkuar manualisht në një stacion

Në modalitetin e kërkimit, shtypni / vazhdimisht për të zgjedhur një frekuencë.

Ruajtja automatikisht e stacioneve të radios FM

Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje FM.




Në modalitetin e kërkimit FM, shtypni dhe mbani shtypur për tre sekonda.

- ↳ Ora radio ruan automatikisht të gjitha stacionet radio FM të disponueshme.
- ↳ Stacionet e para të disponueshme transmetohen automatikisht.

Ruajtja manualisht e stacioneve të radios FM

Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje FM.



- 1** Në modalitetin e kërkimit FM, shtypni dhe mbani shtypur **TUNE** për tre sekonda.
↳
- 2** Shtypni / vazhdimisht për të zgjedhur një frekuencë.
- 3** Shtypni për të konfirmuar.
↳ Numri i caktuar paraprakisht fillon të pulsojë.
- 4** Shtypni / për të zgjedhur një numër.
- 5** Shtypni për të konfirmuar.
- 6** Përsëritni hapin **2 deri në 5** për të ruajtur stacione të tjera.

Shënim

- Për ta fshirë një stacion të ruajtur paraprakisht, ruani një stacion tjetër në vend të tij.

Zgjidhni një stacion radioje FM të caktuar paraprakisht

Në modalitetin e kërkimit FM, shtypni . Shtypni / vazhdimisht për të zgjedhur një stacion radio të caktuar paraprakisht.

Rregullimi i volumnit

Ndërsa dëgjoni radion FM, shtypni vazhdimisht për të rritur ose ulur volumnin.


5 Vendosja e alarmit

Vendosja e alarmit

Mund të vendosni që të bien dy alarme në orare të ndryshme.


Shënim

- Sigurohuni që ta keni vendosur orën si duhet.




- 1 Prekni sipërfaqen e orës për të aktivizuar butonat me prekje.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur  për tre sekonda për të shkuar te vendosja e alarmit.
- 3 Shtypni  /  për të zgjedhur AL1 ose AL2.
- 4 Shtypni  për të konfirmuar.
↳ Shifrat e orës fillojnë të pulsojnë.
- 5 Shtypni  /  vazhdimisht për të vendosur orën.
- 6 Shtypni  për të konfirmuar.
↳ Shifrat e minutave fillojnë të pulsojnë.
- 7 Shtypni  /  vazhdimisht për të vendosur minutat.
- 8 Shtypni  për të konfirmuar.
- 9 Shtypni  /  për të zgjedhur burimin e alarmit: sinjalizuesi ose stacioni i radios FM që keni dëgjuar për herë të fundit.
- 10 Shtypni  për të konfirmuar.

Aktivizimi/çaktivizimi i alarmit



- 1 Prekni sipërfaqen e orës për të aktivizuar butonat me prekje.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur  për tre sekonda për të shkuar te vendosja e alarmit.
- 3 Shtypni  /  për të zgjedhur AL1 ose AL2.
- 4 Shtypni sipër orës për të zgjedhur ndezjen ose fikjen e alarmit.
- 5 Shtypni  për të konfirmuar.

Shtyrja/ndalimi i alarmit



Kur bie alarmi, shtypni sipër orës për të aktivizuar shtyrjen e alarmit.

- ↳ Alarmi shtyhet dhe bie përsëri nëntë minuta më vonë.




Kur bie alarmi, shtypni ekranin e orës për ta ndaluar alarmin.

- ↳ Alarmi bie përsëri ditën tjetër.

6 Veçori të tjera

Vendosja e shtyrjes së alarmit




Shtypni **ZZ** vazhdimisht për të zgjedhur kohën e shtyrjes së alarmit (në minuta).

↳ Ora radio kalon automatikisht në gjendje pritjeje pas periudhës së caktuar paraprakisht.

Për të çaktivizuar shtyrjen e alarmit:

Te modaliteti i vendosjes së shtyrjes së alarmit, shtypni **ZZ** vazhdimisht derisa të shfaqet [OFF].

Rregullimi i ndriçimit të ekranit



- 1 Prekni sipërfaqen e orës për të aktivizuar butonat me prekje.
- 2 Shtypni **Light** vazhdimisht për të zgjedhur nivele të ndryshme ndriçimi:
 - I lartë
 - Mesatar
 - I ulët

Drita e natës




I lartë
↓
I ulët
↓
Fikur

Në gjendjen në pritje, shtypni vazhdimisht sipër orës për të zgjedhur nivele të ndryshme ndriçimi për dritën e natës.

- I lartë
- I ulët
- Fikur

Karikimi i pajisjes me anë të portës USB



Lidhni anën me madhësi standarde të kabllit USB (nuk është përfshirë) në portën USB mbrapa pajisjes dhe anën tjetër në portën e karikimit të pajisjes.

7 Informacione për produktin

Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

Specifikimet

Amplifikatori

Fuqia totale në dalje 1 W RMS

Kërkimi (FM)

Rrezja e kërkimit 87,5 - 108 MHz

Rrjeti i kërkimit 50 KHz

Stacione të ruajtura 20

Karikim USB DC 5V, 1 A / Prizë Type-A

Informacione të përgjithshme

Energjia - Energji AC Emri i markës: PHILIPS;

Modeli:
ASI50-050-AEI50

Hyrja: 100 - 240V~,
50/60 Hz, 0,7 A;

Dalja: 5V 1,5 A

Energjia - Bateria CR2032
(ruajtja e orës)

Konsumi i energjisë në
gjendje pritjeje <1 W

Përmasat - Njësia kryesore (Gje x La x The) 110 x 110 x 55 mm

Pesha - Njësia kryesore 0,27 kg

Pesha - Me paketim 0,47 kg

8 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e kësaj pajisjeje.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni sistemin vetë.

Nëse hasni probleme ndërsa përdorni pajisjen, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe të keni gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

Nuk ndizet

- Sigurohuni që spina e energjisë AC të orës radio është lidhur si duhet.
- Sigurohuni që ka energji në prizën AC.

Ora radio nuk përgjigjet

- Shkëputeni dhe lidheni përsëri spinën e energjisë AC, më pas ndizeni radion përsëri.

Marrje e dobët e sinjalit

- Mbajeni orën radio larg nga pajisjet e tjera elektronike për të shmangur interferencat e sinjaleve radio.
- Zgjatni plotësisht dhe rregulloni pozicionin e antenës në formë bishti.

Alarmi nuk punon

- Vendoseni si duhet orën/alarmin.

9 Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund ta bëjë të pavlefshme autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen. Këtu, MMD Hong Kong Holding Limited deklaroi se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin

dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), pulpë letre (amortizuesi) dhe polietilen (qeset, fletë mbrojtëse sfungjeri).

Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.



2019 © Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të regjistruara tregtare të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

